

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

11/30/2017

LOERMA SHPK

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

1.1 Të përgjithëshme

2. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT

3.1 Pozita gjeografike

3.2 Klima

3.3 Arkeologjia

3.4 Burimet ujore

3.5 Flora dhe Fauna

4. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Profili i propozuesit

4.2 Informacin për qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njësia e qeverisjes vendore që administron territorin ku zhvillohet projekti)

4.3 Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit)

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 Ndikimet nga zhurma

5.2 Ndikimet në tokë

5.3 Ndikimet në ajër

5.4 Ndikimet në florë dhe fauna

5.5 Ndikimet mbi trashgiminë arkeologjike, kulturore dhe historike

5.6 Ndikimet me natyrë ndërkufitare

5.7 Ndikimet në ujëra

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

1. HYRJE

TË PËRGJITHËSHME

Subjekti PETRIT QOSJA është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti K73029205N. me vend të ushtrimit të aktivitetit në Elbasan Shirgjan SHIRGJAN SHIRGJAN.

Në bazë të ligjit Nr. 60/2014 Për një ndryshim në ligjin nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” I ndryshuar, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me ID:

“ID 5.8, menaxhimi I mbetjeve: Magazinimi, rikuperim I hekurishteve/skrapeve të metalit ose cmontimi I mbetjeve nga motorët e makinave.”

Aktiviteti merr në konsideratë masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi I tyre të kryhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut dhe pa I sjellë dëme mjedisit, vecanërisht:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa dëmtuar peisazhin

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Në këtë aktivitet të subjektit janë punësuar disa punonjës për kryerjen e punës dhe funksionimit e saj në vazhdimësi.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë problem mjedisore të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës. së bashku me zhvillim e madh që është bërë në industry të ndryshme në mënyrë të ngjashme me të njëjtën shpejtësi është rritur edhe sasia e mbetjeve nga përdorimi I të mirave material. Mbetjet industrial dhe ato urbane të patrajtuara , emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi I kimikateve të reja pa marrë parasysh dëmet që mund ti sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballemi ditët e sotme

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

Kur parametrat mjedisorë nuk janë conform ligjeve, normave dhe rregullave të mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje të tij dhe prishje të ekuilibrave natyrorë. Nxitja e zbatimit të këtyre normave kërkon një përkujdesje nga ana e organeve legjislativë dhe vendimmarrëse në mënyrë që të rritet interesi si dhe detyrimi për ruajtjen e ekuilibrave natyrorë.

Kjo është arritur duke:

- Dhënë gjëndjen reale nga pikëpamja e ndikimit të këtij aktiviteti në mjedis.
- Analizuar faktorët pozitivë dhe negativë mjedisorë
- Dhënë rekomandime për masat zbutëse dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis

Për këtë është shfrytëzuar:

- Informacioni bazë I zonës
- Dokumentacioni juridik dhe teknik I subjektit

2. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

- Ligji nr.10431 Datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Vendim nr.805 datë 04.12.2003 “Për miratimin r listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis për të cilat kërkohet leje mjedisore”
- Udhëzim nr.1 datë 03.03.2009 “për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB
- Udhëzim për dokumentacionin e duhur për “Leje Mjedisore”
- Urdhëri nr. 321 datë 11.02.2014 “Për lejet Mjedisore”
- Udhëzim I MM dhe MF nr.7938 datë 17.07.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”
- Vendimit nr. 686 datë 29.07.20156 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- Ligji nr.12/2015 datë 26.02.2015 “Për disa ndryshime në ligjin 10440 datë 07.07.2011 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË RAJONIT

3.1 POZITA GJEOGRAFIKE

Qyteti i Elbasanit ndodhet në Shqipërinë e Mesme. Ai shtrihet në fushën e Elbasanit, në krahun e djathtë të rrjedhjes së mesme të lumit [Shkumbin](#), i rrethuar në lindje nga Krasta e Madhe dhe e Vogël, në veri dhe veriperëndim nga kodrat e Ullishtave, në perëndim nga përroi i Zaranikës, në jug kufizohet nga lumi Shkumbin. Në anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazderies. Elbasani është i vendosur midis gjerësive gjeografike veriore 41° 27', jugore 40° 10', lindore 20° 34' dhe perëndimore 19° 03' dhe ndodhet në një lartësi mesatare prej 125 m mbi nivelin e detit. Rajoni I Elbasanit shtrihet në një zonë kodrinore-malore dhe pjesërisht fushore. Zona malore shtrihen kryesisht në very-lindje e jug-lindje dhe zonat kodrinore e fushore në lindje e jug-lindje.

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

3.2 KLIMA

Klima e rajonit dallohet për diversitetin e saj. Zona fushore dhe kodrinore karakterizohet nga një klimë mesdhetare me verë të nxehtë (26 °C e dimër të butë. (10 °C)

Zona malore karakterizohet nga një klimë me verë të freskët (20-23 oC) dhe një dimër të lagësht e shpeshherë të ashpër. Reshjet mesatare arrijnë në 1100-1200 mm në vit në zonat e ulëta dhe 1500-2000 mm në vit në zonat malore. Erërat fryjnë në dimër nga verilindja e lindja të ftohta, në verë nga jugperëndimi e perëndimi e veriperëndimi.

3.3 ARKEOLOGJIA

Teatri “Skampa”

Teatrit “Skampa” është i ndërtuar në vitin 1938 nga Xhavit Bej Bicaku dhe ka një kapacitet prej 292 vendesh. Akustika e këtij teatri është një nga më të mirat në Shqipëri. Aktualisht është në gjendje të mirë, por ka nevojë për përmirësimin e fonie, ndriçimit dhe ngrohje-ventilimit. Por me date 4 Gusht 2011 teatri skampa u perfshi nga flake te medha e u be shkrumb e hi. Ai u rregullua dhe tani eshte ne gjendje te mire edhe pse ka defekte te ndryshme.

Muzeu “Aleksandër Xhuvani”

Muzeu “Aleksandër Xhuvani”, gjendet ne pjesën veriore te kalasë se Elbasanit, ne shtëpinë ku lindi dhe u rrit prof. Aleksander Xhuvani i cili ka një veprimtari te dendur politike, arsimore, kulturore dhe gjuhësore, duke u bere një nga figurat me te rëndësishme te etapës se fundit te epokës se rilindjes kombëtare shqiptare.

Muzeu “K. Kristoforidhi”

Muzeu “K. Kristoforidhi” është ngritur ne vitin 1978, ne kuadrin e 100 Vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit dhe 150 Vjetorit te lindjes se Kostandin Kristiforidhit. Ky muze pasqyron ne mënyre te përmbledhur jetën dhe veprimtarinë patriotike te studiuesit dhe lëvruesit te gjuhës shqipe dhe përfaqësues i epokës se Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Muzeu gjendet ne lagjen Kala ne një shtëpi karakteristike te saj ku lindi dhe u rrit ky personalitet. Pas riparimit, me financime te bashkisë Elbasan ne vitin 2001, muzeu është i vizitueshem.

Shtëpia e Kulturës

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

Shtëpia e Kulturës është godina ku nuk është bërë asnjë investim pasi mendohet që kjo godinë do të priset për hapjen e rrugës. Lidhur me këtë plani rregullues duhet të shqyrtoje këtë ide dhe në rast se propozohet prishja e saj duhet të identifikojë një shesh të ri. Brenda këtij institucioni funksiononte një sallë koncertesh me kapacitet rreth 250 personash.

3.4 BURIMET UJORE

Elbasani ka pasuri të mëdha ujore. Lumenjtë kryesorë janë Shkumbini dhe Devolli. Elbasani shquhet vecanërisht për liqenjtë e tij me origjinë karstike të vendosur në pllajën e Dumresë, të cilët njihen me emrin “Liqenjtë e Belshit”. E tërë zona e Elbasanit është e pasur me burime ujrash nëntokësorë, natyralë e sidomos dallohen për cilësinë e tyre gurrat malore me ujin e ftohtë e të paaastër. Gjithashtu Elbasani shquhet për burimet termale të llixhave me vetitë curative.

3.5 FLORA DHE FAUNA

Zona e Elbasanit ka një florë dhe faunë të pasur, të cilat favorizohen nga larmia e klimës ku gjejnë kushtet ideale të gjitha llojet e specieve tipike për zonën e mesdheut. Brezi i shkurreve mesdhetare

Brezi i dushqeve, Brezi i ahut dhe pishes.

Kullotat shtrihet në lartësi 1700-1800m në malet e Shpatit dhe të Shmilit. Këto bimë janë ndërthurura me njëra tjetrën duke krijuar pyje shumë të bukura. Këto pyje përbejnë dhe pjesën më të rëndësishme të fondit pyjor i cili shfrytëzohet edhe për qëllime industriale. Kullotat e rrethit të Elbasanit janë dimeror dhe verore.

Kullotat dimerorendodhet në zonën e ulet të rrethit: Perparim, Pavoje, Paper, Dumre.

Kullotat verorendodhet në lartësi të mëdha, mbi brezin e dushkut. Kryesisht ato ndodhet në Shmil, Gjinar, Zavaline

Fauna

Rrethi Elbasanit ka një botë shtazore të pasur në shumëllojshmëri. Këto e favorizojnë sipërfaqet e mëdha pyjore, klima e ngrohtë, ujërat e shumta. Më të përhapurat janë lepuri dhe dhelpra, të cilat ndodhen në katet e bimesive. Në zonën e shkurreve takojmë cakallin, qelbesin dhe vjerdullin. Në zonat malore të Gjinarit haset derri i eger dhe ariu.

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

Shpendet me te perhapur jane:harabelet,laraska sorra,thelleza e malit dhe fushe,ne zonen e Dumrese takojme shpende migrues si rosa e eger,shapka etj.

Peshqit jane te perhapur ne zonen e dumrese ku permendim:krapin,ballegjerin,cironken.Ka raste qe ne liqenet ku realizohet rritja artificiale peshqit arrijne deri ne 30-40 kg

4. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti PETRIT QOSJA kryen aktivitetin “Transport ,grumbullim dhe tregetim skrapit”. Subjekti është regjistruar në QKB më datë 20/07/2006 me formë ligjore si person fizik, I pajisur me nr. Identifikimi NIPT: L21331010C me përfaqësues ligjor PETRIT QOSJA. Ky subject ushtron aktivitetin e tij në Elbasan Shirgjan SHIRGJAN SHIRGJAN

Aktiviteti që ushtrohet për demontimin e pjesëve të ndryshme të makinave është instaluar në një sipërfaqe të konsiderueshme. Numri I njerëzve që punojnë në këtë aktivitet është rreth 5 punonjës.

Pra me këtë Përmbledhje Joteknike jepet informacion për projektin që është realizuar, vlerësimin e ndikimeve negative në mjedis si dhe proceset e punës që kryhen në këtë subject. Vendndodhja ku subjekti ushtron aktivitetin ka koordinatat e mëposhtëme të përcaktuara sipas sistemit GAUSS-KRUGER.

X1= 4421922.680

Y1=455061.865

X2=4421887.895

Y2=4550696.076

X3=4550775.093

Y3=4550775.093

X4=4422133.535

Y4=4550687.657



DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

Duhet theksuar se aktiviteti funksionon si një servis që ka si veprimtari kryesore demontimin manual të pjesëve të ndryshme të makinave jashtë jete dhe pastaj magazinimin e këtyre pjesëve dhe shitjen e tyre si material skrap. Pra mund të konfirmojmë se nuk ka cilime të gazrave apo shkarkime të tjera të dëmshme të rrezikshme e me natyrë ndotjeje. Duhet theksuar se aktiviteti ndodhet në daljen jugore të qytetit larg qendrave të banuara në një zonë të izoluar të komunës Shirgjan. Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë sjell vetëm ndikime positive sepse punëtorët e punësuar aty vijnë nga fshatrat përreth duke rritur kështu mirëqënien e tyre ekonomike. E gjithë zona nuk ka objekte të mbrojtura gjeologjike apo zona me interes gjeologjik.



DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

Gjatë kryerjes së proceseve të punës subjekti përdor si lëndë të parë makinat e aksidentuara që nuk rregullohen më ose që rregullimi i tyre nuk sjell leverdi ekonomike pra makinat në fund të jetës.

Produkti përfundimtar i përfituar pas kryerjes së proceseve të punës janë:

- Baza e makinës (e cila cohet për skrap)
- Pjesë motorrike e gjenerike (Shiten subjekteve që merren me këtë aktivitet)
- Gomat dhe vajrat (merren nga subjekte të licencuara)
- Pjese plastike (depozitohen në pikën e grumbullimit të bashkisë Elbasan)

Kapaciteti i këtij subjekti është 10 makina/javë.

Të gjitha këto shërbime ofrohen nga një staf i kualifikuar në kryerjen e proceseve të punës dhe nga teknologjia më e fundit duke ofruar kështu shërbime të shpejtadhe cilësore. Ky subject është i fokusuar në vendosjen e standarteve personale përse i përket shërbimeve duke projektuar me shumë përgjegjësi te cdo klient dhe partner që ka.

I orientuar drejt shërbimeve profesionale subjekti do të vazhdojë të ofrojë shërbime të tilla si demontimi i mjeteve dhe riciklimi total i tyre. Demontimi i makinave nënkupton heqjen e të gjitha pjesëve të papërorshme në një mjet motorrik, makinë furgon apo motor.

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

5.1 NDIKIMET NGA ZHURMA

Ndikimet nga zhurmat përfshijnë zhurmat e shkaktuara nga mjetet e punës që përdoren në këtë aktivitet. Duhet theksuar se kët cdo process pune është terësisht manual ndaj zhurmat e vetme shkaktohen nga lëvizja e mjeteve motorrike.

5.2 NDIKIMET NË TOKË

Mbeturinat e ngurta të cilat shkaktohen nga aktiviteti human, mbetje urbane të plastikës, qelqit, kartona etj janë të riciklueshëm dhe hidhen në kazanët e bashkisë. Të gjitha llojet e mbetjeve të tjera blihen nga subjekte të licencuara.

DEMONTIM I MAKINAVE, PIKË SKRAPI

5.3 NDIKIMET NË AJËR

Subjekti ushtron një aktivitet të tillë i cili nuk gjeneron tymra, gaze, aroma, pluhura apo komponentë të tjerë të dëmshëm të kësaj natyre. Në ambiente e punës nuk ka as oxhak, as furra djegjeje dhe asnjë lloj procesi që lidhet me to. Kështu që ndikimi që subjekti ushtron në ajër është zero.

5.4 NDIKIMET NË FLORË DHE FAUNË

Aktiviteti zhvillohet në një ambient të hapur dhe brënda sipërfaqes së përcaktuar për këtë qëllim kështuqë nuk ka lidhje me mjedis tjetër, për rrjedhojë as derdhje të shkarkimeve apo mbeturinave që mund të shkaktojnë ndryshime në florën e faunën e zonës.

5.5 NDIKIMET MBI TRASHËGIMINË ARKEOLOGJIKE, KULTURORE DHE HISTORIKE

Aktiviteti që ushtron subjekti zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historinë apo tiparet arkeologjike.

5.6 NDIKIMET ME NATYRË NDËRKUFITARE

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyrë ndërkufitare sepse ndodhet brënda territorit të bashkisë Elbasan dhe nuk ka kufijë tokësore me shtetet e tjera që kufizojnë Republikën e Shqipërisë.

5.7 NDIKIMET NË UJËRA

Nga zhvillimi i proceseve të punës së këtij subjekti nuk ka gjenerim të ujërave të ndotur. Të vetmet ujëra që shkarkohen nga subjekti janë ujërat sanitarë për larjen e ambienteve. Këto ujëra shkarkohen në një kolektor e më pas në rrjetin e qytetit të Elbasanit.